

Simptomat e kancereve më të shpeshta te mashkulli

ZORRA E TRASHË

- Gjak që i jep jashtëqitjes ngjyrë të kuqe ose të zezë.
- Nevojë e rreme.
- Ndryshime të jashtëqitjes: të forta dhe/ose të lëngshme (alternime midis kapsllëkut dhe diarresë).
- Dhimbje të vazhdueshme barku.

PROSTATA

- Dhimbje ose djegie në momentin e urinimit.
- Vështirësi urinimi.
- Dobësimi i skurrjelit të urinës.
- Nevoja e shpeshtë për të urinuar.
- Gjak në urinë.
- Gjak ose dhimbje gjatë derdhjes.

MUSHKËRITË

- Kollë që vazhdon më shumë se prej 4 javësh.
- Kollë kronike që përkeqësohet.
- Infeksionet e mushkërive që nuk shërohen pavarësisht antibiotikëve.
- Gjak në pështymë.
- Vështirësi të pazakonshme të frymëmarrjes duke ngjitur shkallët.
- Dhimbje gjoksi.

LËKURA

Njolla normale



Njolla që duhet të kontrollohen



Forma e rregullt?



Skajet e përcaktuara mirë?



E njëjta ngjyrë kudo?



Ndryshimi i madhësisë?
i formës? i ngjyrës?
i trashësisë?

Nëse vëreni një nga këto simptoma, kjo nuk do të thotë se ju keni kancer.

Caktoni takim me një mjek për një kontroll.

Ekzaminimi për kontrollin e kancerit të zorrës së trashë



Unë jam 50 vjeç ose më shumë dhe vendos të bëj një kontroll.



Plotësoj një pyetësor me një profesionist të shëndetit, i cili më jep një test për zbulimin e gjurmëve të gjakut në jashtëqitje.



E bëj vetë testin në shtëpi dhe e dërgoj në laborator duke përdorur zarfin e ofruar për këtë punë.



Rezultatet më vijnë përmes postës, pas një jave.

- Nëse testi është normal, marr një bon për të ribërë kontrollin brenda 2 vjetësh.
- Nëse testi tregon se ka gjak në jashtëqitjen time, unë e thërras mjekun tim të familjes, i cili do të më dërgojë për të bërë një ekzaminim plotësues (Kolonoskopia *). Nëse nuk njoh një mjek, Fondacioni vaudoise për zbulimin e kancerit merr kontakt me mua.



Ky kontroll më kushton rreth 5 franga. Sigurimi shëndetësor merr përsipër pjesën tjetër.

Kolonoskopia mund të zgjidhet si test i parë i kontrollit të kancerit të zorrës së trashë.

Çfarë mund të bëni çdo ditë për shëndetin tuaj:



ecni të paktën 30 minuta



hani 5 fruta dhe perime



kufizoni alkoolin në një gotë



mbroni veten nga dielli



shmangni pirjen e duhanit

Nëse kam pyetje?
Thërras Fondacionin Vaudoise
për zbulimin e kancerit në nr. e
telefonit:



0848 990 990



Kanceri i zbuluar në fillim
të sëmundjes
rrit shanset e shërimit!



ligue vaudoise contre le cancer

unisanté

Centre universitaire de médecine générale
et santé publique • Lausanne

Albanais